



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada – Government**

---

**Rregullore e Punës së Kuvendit Komunal të Kllokotit- Vërbocit**

---

**02.Shkurt 2010**

---

# Rregullore e Punës së Kuvendit Komunal të Klllokotit- Vërbocit

---

02.Shkurt 2010

Në pajtim me nën-nenet 2 (b) dhe 4 (b) të nenit 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr.03/L-0140) Kuvendi Komunal i Komunës së Klllokotit – Vërbocit, në seancën e mbajtur më 02.02.2010, miratoi këtë Rregullore të Punës:

## Neni 1

1.1 Rregullorja e punës përcakton detyrat dhe mënyrën e funksionimit të kuvendit komunal të komunës.

1.2 Kjo rregullore e punës do të aplikohet edhe për komitetet e kuvendit komunal *mutatis mutandis*.

## Neni 2

Në këtë rregullore të punës, termet më poshtë do të kenë kuptimin si në vijim:

“**Komunë**” nënkupton komunën e Klllokotit-Vërbocit.

“**Sekretariati i Kuvendit**” nënkupton shërbimet relevante që i ofrojnë ndihmë kuvendit komunal dhe organeve të tij.

“**Çështje urgjente**” nënkupton një çështje që ka të bëjë me situatë vërtetë emergjente për të cilën kuvendi duhet të vendosë dhe e cila nuk mund të trajtohet në kuvend brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

“**Fjalët dhe veprimet fyese**” nënkupton fjalët e folura apo të shkruara që përdoren në kuvendin komunal apo në komitetet e tij dhe të cilat:

- a) Janë fyese apo kërcënuese,
- b) Janë sulme personale apo ofendime,
- c) Nuk janë në gjuhë parlamentare,
- d) Nxisin dhunë,
- e) Nxisin dhunë gjinore,
- f) Akuzat e drejtpërdrejta kundër çdo anëtarit të kuvendit komunal apo drejtorit të drejtorisë.

“**Grupi parlamentar**” nënkupton një grup prej tre a më shumë anëtarëve të një partie, koalicioni apo iniciative të qytetarëve të cilët janë anëtarë të kuvendit dhe të cilët e kanë informuar kryesuesin e kuvendit komunal për qëllimin e tyre për të vepruar si grup parlamentar.

“**Javë e punës**” nënkupton javën e punës gjatë së cilës kuvendi komunal mban seancë, përveç javës kur kuvendi mbledhet gjatë ditëve jo të punës për të diskutuar çështje urgjente.

“**Dita e punës**” do të thotë dita e javës nga e hëna deri të premten, duke përjashtuar pushimet publike, gjatë javës kur kuvendi normalisht takohet.

